

Bazuar në nenin 12, paragrafin 4 të Ligjit Nr. 03/ L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, bazuar në Ligjin Nr. 04/L-077, Për Marrëdhëniet e Detyrimeve, nenin 78 (4) të Ligjit Nr. 04/L/109, Konkluzioni nga mbledhja 44 e Bordit Drejtues, dt.09/08/2019 Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), shpall:

KONKURS PUBLIK
për
Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Titulli i vendit të punës:	Ekspert (një)
Numri i referencës:	1/2019 - MSHV
Niveli i pagesës së shërbimit:	I negociuar
Lloji i kontratës:	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta (MShV)
Kohëzgjatja e marrëveshjes:	Dy muaj kalendarikë

Eksperti për ngritjen e kapaciteteve institucionale, sipas kërkesave të ARKEP, bazuar në kuadrin kushtetues dhe ligjor përkatës lidhur me funksionet e ARKEP dhe pas analizës së kryer të funksionimit të kontrollit të brendshëm, në zbatim të politikave të administrimit të ARKEP dhe sistemit të Burimeve Njerëzore të saja, do të ofroj asistencën teknike, mbështes dhe ndihmoi menaxhmentin dhe Grupin e Punës së ARKEP në:

1. Përgatitjen dhe zhvillimin e modulit për Grupin e Punës në temat: “Ri-dizajnimi i strukturave organizative në kontekst të legjislativës së ri për reformën e administratës publikë-” proceset dhe hapat e zbatueshëm që duhet ndërmarrë, si dhe “Teknikat legjislative dhe normëzimi i politikave të Burimeve Njerëzore në kontekst të ndryshimeve organizative, rregullave dhe proceseve të punës në ARKEP”;
2. Rishikimin, hartimin dhe finalizimin e Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në ARKEP;
3. Rishikimin dhe finalizimin e përshkrimit të detyrave të punës, klasifikimin e vendeve të punës për nëpunësit e ARKEP;
4. Skicimi i Organogramit të ARKEP;
5. Pjesëmarrja në Punëtori të Grupit të Punës lidhur me trajtimin, shqyrtimin dhe finalizimin e dokumenteve të përgatitura, siç janë nënvizuar në pikët si më sipër.

Kualifikimet dhe Përvoja:

Kandidati për ekspert për ngritje të kapaciteteve institucionale duhet të posedojë:

- Përgatitje universitare në drejtësi apo administratë publike, diplomë Master është e preferueshme.
- Së paku 10 vjet përvojë pune profesionale të mëparshme përkatëse me detyrat e kërkuara në administratën publike, duke përfshirë njohje të thellë të rregullave, procedurave dhe proceseve të ndërtimit dhe ri-dizajnit të strukturave të brendshme organizative, si dhe të vendosjes dhe

zbatimit të politikave të Sistemit të menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në bazë të standardeve, parimeve dhe praktikave më të mira, për të asistuar/udhëhequr në mënyrë adekuate ekipe pune dhe për ta këshilluar klientin mbi menaxhimin e ndryshimit të strukturave të brendshme organizative dhe administrimin e Burimeve Njerëzore në mënyrë të duhur dhe të suksesshme;

- Njohuri të shkëlqyer lidhur me mandatin kushtetues dhe ligjor të ARKEP.
- Aftësi të mira dhe ekspertizë të lartë në konceptimin dhe hartimin e politikave të veprimit, hartimin e dokumenteve dhe akteve ligjore, nga fushëveprimtaria e institucioneve publike, me theks të posaçëm të ARKEP.
- Eksperiencë specifike në zbatimin e teknikave legjislativë, në hartimin dhe apo ri-përshkrimin e detyrave të punës, si dhe në zhvillimin e moduleve të trajnimeve në fushat përkatëse të rishikuara të ARKEP-it.
- Aftësi të forta analitike, komunikimi, shkrimi dhe aftësi të raportimit;
- Aftësi të forta kompjuterike (Windows, MS Office, Internet Explorer);
- Aftësi të shkëlqyera të punës në ekipe me staf menaxherial dhe profesional;
- Gatishmëri për të përmbushur detyrat brenda kohës së parashikuar për kryerjen e shërbimit, me cilësi të lartë dhe efektivitet, si dhe të jetë person me integritet të lartë profesional dhe personal.
- Njohje të shkëlqyer, në të folur dhe të shkruar të gjuhëve zyrtare në Republikën e Kosovës.
- Certifikatën e Numrit Fiskal nga Administrata Tatimore e Kosovës.

Kandidati i interesuar për Ekspert me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta,

duhet të paraqes:

- Kornizën e Planit operacional të Punës në zbatim të detyrave/punëve sipas termave të referencës,
- Biografinë profesionale (CV)
- Letren motivuese
- Kualifikimin dhe përvojën e punës profesionale perkatëse.

Kohëzgjatja e kontratës:

- 2 muaj

Çmimi (kostoja e shërbimit):

- I negociuar

Kushtet për pjesëmarrje në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, të cilët kanë zotësi të plotë të veprimit, përgatitjen e kërkuar arsimore si dhe ekspertizën dhe aftësinë profesionale në kryerjen e detyrave përkatëse.

Procedurat e konkurrimit:

Procedura e konkurrimit është e hapur.

Paraqitja e aplikacioneve:

Aplikacionet dorëzohen në zyrën e Sekretarisë së Autoritetit ose (Rr. Bedri Pejani, nr.23 - Prishtinë) ose të dërgohen përmes postës.

Konkursi mbetet i hapur 8 ditë kalendarike nga dita e publikimit, përkatësisht nga **data 02/09 2019 deri më .09/09/2019**, që konsiderohet dita e fundit e mbylljes së konkursit.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të ftohen në intervistë, nëpërmjet telefonit.